




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Në mbështetje të nenit 4 lidhur me nenin 13 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve për destinimin e mjeteve nga fondet për transfer dhe subvencione për OJQ të cilat operojnë në territorin e Komunës së Rahovecit. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, bën këtë:

-III- Nr. I prot. 1798 Më Dt. 05.06 2020
 RAHOVEC - ORAHOVAC

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport përmes kësaj shkrese ju bën thirrje publike për aplikim të gjitha OJQ-ve, të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë brenda Komunës së Rahovecit dhe që fushëveprimtari kanë sportin dhe projektet që ndërlidhen me përfshirjen e talentëve të rinj në fushën e sportit, të aplikojnë për mbështetje financiare nga subvencionet për Kulturë, Rini dhe Sport.

Qëllimi

Qëllimi i kësaj thirrjeje publike është subvencionimi dhe mbështetja financiare për të gjitha klubet e sportit dhe OJQ-të që aktivitetin dhe fushëveprimtarinë kryesore e kanë sportin dhe projektet të cilat ndërlidhen me vetëdijsimin dhe involmimin e të rinjëve të Komunës së Rahovecit për zhvillimin e aktiviteteve sportive.

Specifikat e thirrjes publike

- Thirrja publike për aplikim hapet më 05.06.2020 dhe mbyllet më 25.06.2020 ora 16:00h .
- Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së afatit për aplikim nuk do të pranohen.
- Aplikacionet e pa kompletuara sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje do të refuzohen.
- Zbatimi i projekteve do të monitorohet nga personi përgjegjës i përcaktuar nga DKRS.
- Mbështetësi financiar, përkatësisht Komuna e Rahovecit dhe përfituesi i subvencionit (OJQ) do të lidhin kontratë me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.
- Me secilën OJQ, që do të jetë përfituese e subvencionit do të nënshkruhet një kontratë në mes të përfituesit të mjeteve financiare dhe mbështetësit financiar.

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencionit

- Projekt-propozimi, përfshirë, agjendën, aktivitetet, planifikimi dhe linja buxhetore në harmoni me qëllimin e projektit.
- Formulari i aplikacionit.
- Kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar,
- Çertifikata me numër të regjistrimit të OJQ-s dhe me numër fiskal
- Dëshmi që nuk ka obligime ndaj ATK-së
- Kopja e kartelës së xhirologarisë dhe konfirmimi bankar i xhirologarisë së aplikuesit,
- Vërtetim nga DKRS, për dorëzimin e raportit financiar nga subvencionet e vitit paraprak.

Mënyra e aplikimit

- Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarf të mbyllur,
- Brenda zarfit vendosen një kopje e të gjitha dokumentacionit origjinal të kërkuara si dhe kopja elektronike në CD,
- Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimit në katin e parë në objektin e Komunës.

